UDHËZIM
Nr. 241/3, datë 19.2.2016

MBI KARAKTERISTIKAT E MATERIALIT, ELEMENTET E SIGURISË, ELEMENTET GRAFIKE DHE MËNYRËN E PLOTËSIMIT TË LEJEDREJTIMIT TË RI TË MJETEVE RRUGORE[1]

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 115/1, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit nr. 292, të "Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës,

UDHËZON:

Neni 1
Karakteristikat fizike të lejedrejtimit

1. Përmasat e lejedrejtimit janë sipas standardit ISO/IEC 7810, formati ID-1.
2. Karakteristikat fizike të lejedrejtimit janë sipas standardit ISO 7810 dhe ISO 7816-1.
3. Materiali i kartës duhet të jetë:
a) Polikarbonat;
b) Me jo më pak se 4 (katër) shtresa;
c) Me jetëgjatësi jo më pak se 10 (dhjetë) vjet;
d) I përshtatshëm për gdhendje dhe personalizim me lazer.
4. Metodat e testimit për verifikimin e karakteristikave të lejes së drejtimit që garantojnë përputhjen me normat dhe standardet ndërkombëtare do të jenë sipas standardit ISO 10373.

Neni 2
Elementet grafike, elementet e sigurisë dhe kërcënimet ndaj sigurisë fizike të lejeve të drejtimit

Elementet grafike

1. Në anën e përparme, në krahun e majtë, mbi fotografinë e mbajtësit do të vendoset shenja dalluese e shtetit që e lëshon. Një element oval me ngjyrë të kuqe dhe që në brendësi të tij ka simbolin AL në ngjyrë të zezë.
2. Në anën e përparme, sipër, midis shenjës dalluese të shtetit dhe emrit të shtetit lëshues do të shënohet fjala "LEJEDREJTIMI", e shkruar me germa të mëdha. Poshtë saj do të shkruhet "DRIVING LICENSE".
3. Në anën e përparme, sipër, në krahun e djathtë do të shkruhet emri i shtetit lëshues "REPUBLIKA E SHQIPËRISË". Poshtë saj do të shkruhet "REPUBLIC OF ALBANIA".
4. Në anën e përparme, poshtë, në krah të majtë do të vendosen elemente optike të ndryshueshme.
5. Në anën e përparme në krahun e djathtë do të shkruhet fjala "lejedrejtimi" në gjuhët e Bashkimit Evropian, siç shkruhen në aneksin I, pika 3.e të direktivës evropiane 2006/126/EC.

6. Në anën e pasme, sfondi do të përmbajë fjalinë "MODEL I BASHKIMIT EUROPIAN" në gjuhën shqipe dhe angleze.
7. Të dyja anët e lejedrejtimit do të kenë sfond kompleks me elemente kundër kopjimit me skanim

[1] Udhëzimi synon përputhshmëri të plotë me direktivën nr. Celex 320060126, 2006/126/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e 20 dhjetorit 2006 "Mbi lejet e drejtimit".

dhe printim me efekt ylberi, duke përfshirë "guilloche". Ngjyrat e përdorura duhet të jenë minimalisht 2 (dy) dhe nuk duhet të jenë pjesë e ngjyrave primare (CMYK). Ngjyra bazë do të jetë ngjyra rozë e shoqëruar me blu të hapur. Në këtë sfond duhet të përfshihet dhe mikrotekst.

8. Harta e Shqipërisë do të vendoset në anën e përparme djathtas me ngjyrë të ndryshueshme në varësi të këndit të shikimit.

9. Në pjesën e pasme, majtas, do të ketë dhe barkod QR, që do të përmbajë informacion lidhur me lejedrejtimin përkatës. Përcaktimi i strukturës do të bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR).

10. Të dhënat e personalizuara të mbajtësit të lejedrejtimit, në anën e përparme dhe të pasme të lejedrejtimit mund të lexohen me sy.

Elementet e sigurisë

1. Mikroteksti "REPUBLIKA E SHQIPË-RISË" do të vendoset poshtë fjalëve "LEJE-DREJTIMI" dhe "REPUBLIKA E SHQIPË-RISË".

2. Personalizimi i të dhënave të mbajtësit të lejedrejtimit do të kryhet me gdhendje me laser dhe me reliev.

3. Shkrime të tipit mikrotekst (shkrime të imta të lexueshme me anë të zmadhimit me lupë herë 10). Elementet do të përcaktohen nga DPSHTRR-ja.

4. Elementet optike të ndryshueshme përcakto-hen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

5. Në zonën e fotografisë të mbajtësit të lejedrejtimit, dizenjoja e sigurisë e sfondit të lejedrejtimit dhe fotografia duhet të mbivendosen dhe ndërthuren në mënyrë graduale pa konture të dukshme.

6. Materiali prokat i lejedrejtimit duhet të jetë qartësisht i dukshëm nën rrezet ultraviolet (UV) dhe duhet të përmbajë element të tillë në dy anët e saj dhe i gjithë materiali të reagojë nën këto rreze. Përcaktimi i elementeve bëhet nga DPSHTRR-ja.

Elemente shtesë të sigurisë

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor duhet të përdorë të paktën 3 elemente shtesë të teknikave të mëposhtme:

- bojëra me ngjyra të ndryshueshme;
- bojë termokromike;
- elemente optike të ndryshueshme;
- pamje të ndryshueshme me lazer;
- bojë ultraviolet fluoreshente, të dukshme dhe transparente;
- printim me ngjyrat e ylberit;
- njolla uji dixhitale në sfond;
- pigmente me infra të kuqe apo fosforeshente;
- karaktere, simbole apo dizenjo të prekshme.

Kërcënimet ndaj sigurisë fizike të lejeve të drejtimit

- Prodhimi i kartave false: krijimi i një objekti të ri, i cili ka ngjashmëri të madhe me dokumentin origjinal ose duke e krijuar nga e para ose duke kopjuar dokumentin origjinal.

- Ndryshime të dokumentit: ndryshim i një karakteristike të dokumentit origjinal, p.sh., duke modifikuar të dhënat e shtypura në dokument.

Siguria e përgjithshme qëndron në sistemin si i tërë, i përbërë nga procesi i aplikimit, transmetimi i të dhënave, materiali i kartës, teknika e shtypjes, një sasi minimale e karakteristikave të ndryshme të sigurisë dhe të procesit të personalizimit.

Neni 3

Mënyra e plotësimit të lejedrejtimit

I. Ana e përparme do të personalizohet sipas legjendës së mëposhtme:

1. Mbiemri i mbajtësit (me germa të mëdha);

2. Emri i mbajtësit (me germa të mëdha);

3. Datëlindja dhe vendlindja (datëlindja me numra, data.muaji.viti, sipas formatit DD.MM.VVVV dhe vendlindja me germa të mëdha. Në vendlindje të shënohet shteti në gjuhën shqipe shoqëruar me kodin e shtetit sipas standardit ndërkombëtar);

4.

a) Data e lëshimit të lejedrejtimit (me numra, data.muaji.viti, sipas formatit DD.MM.VVVV;

b) Data e përfundimit të vlefshmërisë (me numra, data.muaji.viti, sipas formatit DD.MM.VVVV;

c) Emri i autoritetit lëshues që është DPSHTRR-ja;

d) Numër tjetër i ndryshëm nga numri i lejedrejtimit, për qëllime administrative (opsional);

5. Numri i lejedrejtimit (me germa të mëdha dhe numra);

6. Fotografia ballore e mbajtësit, bardhë e zi, me rezolucion jo më pak se 200x300 dpi, sipas standardeve;

7. Shkrimi i mbajtësit. Plotësohet nga vetë mbajtësi (emër, mbiemër);

9. Kategoritë e lejedrejtimit që zotëron mbajtësi me germa të mëdha me këtë renditje AM, A1, A2, A, B1, B, C1, C, D1, D, BE, C1E, CE, D1E, DE.

II. Ana e pasme do të personalizohet sipas legjendës së mëposhtme:

10. Data e kualifikimit për çdo kategori lejedrejtimi (me numra, data.muaji.viti, sipas formatit DD.MM.VV. Viti përfaqësohet me dy numrat e fundit);

11. Data e përfundimit të vlefshmërisë për çdo kategori lejedrejtimi (me numra, data.muaji.viti, sipas formatit DD.MM.VV. Viti përfaqësohet me dy numrat e fundit);

12. Informacion shtesë/kufizime në formën e kodeve për (nën) kategoritë përkatëse dhe nëse është e nevojshme e shoqëruar me shënimet përkatëse. Në 12 vertikal do të vendosen kodet që i përkasin kategorisë së lejedrejtimit.

Në 12 horizontal do të shkruhen kodet e drejtuesit të mjetit dhe mjetit.

13. Hapësirë e rezervuar për shënime të ndryshme nga DPSHTRR-ja me informacione të lidhura me administrimin e lejedrejtimit (opsional).

Neni 4

Personalizimi i lejedrejtimit

Personalizimi i lejedrejtimit do të bëhet me germa, numra dhe karaktere të tjera, madhësia dhe stili i të cilave miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Neni 5

Fazat e prodhimit dhe personalizimit të lejedrejtimit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi do të bëjë hartimin e termave të referencës lidhur me lëshimin e lejedrejtimit, duke përfshirë gjithë procesin nga aplikimi deri në lëshimin e lejedrejtimit.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor që në bazë të legjislacionit në fuqi brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi:

a) të përcaktojë fondin e nevojshëm dhe burimin e financimit;

b) të bëjë informimin publik lidhur me leje-drejtimin e ri;

c) të nxjerrë rregullat përkatëse për funksio-nimin e të gjitha hallkave të këtij procesi;

d) të realizojë procedurat për prodhimin dhe personalizimin e lejedrejtimit.

Neni 6

Shfuqizime

Udhëzimi nr. 17, datë 7.1.2003, "Mbi karakteri-stikat e materialit që përdoret për lejedrejtimin, elementet e sigurisë së lartë kundër falsifikimit dhe mënyra e plotësimit të lejedrejtimit të motomjeteve dhe automjeteve", shfuqizohet.

Neni 7

Dispozitë tranzitore

Përjashtimisht, deri në përmbushjen e kërkesave të nenit 5, DPSHTRR-ja do të vazhdojë lëshimin e lejedrejtimit sipas modelit ekzistues.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto